

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-26-2817-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Rregullimi dhe rrethimi i varrezave ne Drenas dhe Komoran**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Treing SH.P.K.
NUI	812136522
Adresa	Rruga Dëshmorët e Ponoshecit, 69
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	049 293 969
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Uljan Thaçi
Adresa elektronike	3ingshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	19.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Rregullimi dhe rrethimi i varrezave ne Drenas dhe Komoran

Njoftimi për kontratë: 29.04.2026

Hapja e paraparë e tenderëve: 19.05.2026

Të pakenaqrur me vendimin e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim po iu drejtohem OSHP me ankesë.

Kriter vlersimi është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim pranë AK:12.05.2026

Vendimi nga AK për kërkesën për rishqyrtim: 14.05.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LPP nr.04/L-042

Neni 1

Neni 6

Neni 7

Neni 27

Neni 69

RRPP-01/2022

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK ka shkelur nenet e lartcekura dhe RRPP ku gjatë hartimit të dosjes së tenderit si dhe parashtrimin të kriterëve per OE ka kërkuar: **2.Makina per lakimin e gypave te hekurit CNCe mpdelit SB-89CNC-SR-H duhet te prezantohet deklarate unile doganore se bashku me fatureë.**

Nese i referohemi paramasës si dhe ekspriences qe kemi, vitin e kaluar 2025 kemi realizuar një kontratë identike(bashkangjitur kësaj ankesë) kjo makineri nuk është e nevojshme si dhe nuk ka asnjë funksion per realizimin e kesaj pune, pasi kjo përdoret për lakimin e tubave apo gypave ndersa ne kemi të bejmë me rrethojë nga panelet e gatshme nga telat 4mm të cilat mund si dhe me shtylla me profil katror 60x60mm, me poshte gjeni tipin e rrethojes sipas paramases

Furnizimi transporti si dhe vurja në vepër e shtyllave metalike dim: [60x60x3.0] mm dhe h=2 m sipas detaleve në projekt duke perfshirë edhe shtyllat mbajtse në kende të trases (rrethojes me rrjetë panel gjithesejt 4 copë), të gjitha shtyllat kryesore (60x60 x3 mm),duhet të jenë të ngjyrosura me ngjyrë elektrostатike. Gjerësia në mes të shtyllave të jet sakt 2.5 m, në mënyrë që paneli të mbështët sakt në shtyllë.

Furnizimi transporti si dhe montimi i rrjetës Panel metalike me trashësi të telit 4 mm, me gjatësi L=2.5 m dhe me lartësi h=1.5m.Rrjeta duhet të jetë galvanizuar 100% në të nxehtë.Shenim: Në qmim të përfshihen edhe tri lidhset për panel rrjeten, të cilat janë adekuate për shtangim të rrjetes për shtyllë

Madje AK ka kërkuar tipin e makinerisë që e bënë këtë kriter dhe me diskriminues, pasi që jo çdo operator mund ta këtë tip, edhe pse e njëjta si makineri po e perserisim prapë që nuk ka të bëjë fare me natyrën e punës sipas paramasës.

AK me datë 14.05.2026 ka publikuar

B54 Formulari standard per korrjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara

Data për hapje të ofertave ka mbetur e njëjta 19.05.2026 me ç, rast na është mohuar e drejta e kohës për ankesë ne OSHP ne një afat prej 10 ditëve nga data e nxjerrjes së vendimit të kërkesës për rishqyrtim, pra ka shkelur ligjin e prokurimit dhe ne si OE kemi qene të diskriminuar.

Bazuar në kreu të kësaj, kërkojmë nga OSHP që të aprovoj pretendimet tona dhe të i kërkoj AK-

së për ta bërë dosjen e tenderit në përputhje me ligjin, rregulloren dhe praktikën e mira të

prokurimit që të ndikojnë pozitivisht edhe në uljen e kostove të vet AK-së. Përpos kësaj e lusim OSHP-në që të i kërkoj AK-së edhe hartimin e dosjes së tenderit duke vendosur kritere

jo kufizuese si dhe proporcionale me natyrën dhe madhësinë e projektit në fjalë.

Marrë për bazë kreu të kësaj që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të shqyrtoj me kujdesë

pretendimet tona dhe të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE “TREING SH.P.K.” lidhur me tenderin

Rregullimi dhe rrethimi i varrezave ne Drenas dhe Komoran

ANULOHET njoftimi për kontratë i AK - KOMUNA GLLOGOC.

AK të detyrohet për angazhim serioz në eliminim të kërkesave kufizuese nga dosja e tenderit.

Gjithashtu ta detyroj që të rishikohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit siç janë referencat

për punët e kryera, kërkesat për stafin dhe certifikimet e tyre, e sidomos ato për pajisjet e nevojshme, duke i harmonizuar ato me LPP-në dhe RRPP-001/2022 si dhe duke ia përshtatur

natyrës së projektit dhe shpenzimit efikas, efektiv e veçanërisht shpenzimit ekonomik të

parasë publike.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse nuk largohen kriteret e tilla që na e pamundësojnë

tenderimin në këtë projekt janë të konsiderueshme në fushën financiare që përbëjnë fitime

të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*